



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2023, ora 14:00 *online*

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13 nëntor 2023.

1. Seancë dëgjimore me aktorë të interesit, sipas kërkesës së sindikatave të arsimit, Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë, për të marrë pjesë në diskutimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” për arsimin.

2. Shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për buxhetin e vitit 2024".

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Florenc Spaho, Blerina Gjylameti, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Baku, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (*zëvendësues*).

Mungojnë:

Flutura Aça, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

Të ftuar:

Isa Rekej – kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës,
Nevrus Kaptelli – president i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë,
Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,
Nina Guga – zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit,

Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,
Mirela Bimo - drejtore e Financave dhe Buxhetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,
Ermelinda Durmishi - drejtore e Politikave të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit
dhe Sportit.

HAPET MBLEDHJA

Evis Kushi – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Në këtë mbledhje kemi 3 pika në rendin e ditës. Do të fillojmë me miratimin e procesverbalit të datës 13 nëntor 2023. Më pas, kemi seancë dëgjimore me grupet e interesit, sipas kërkesës së sindikatave të arsimit, konkretisht me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, për të marrë pjesë në diskutimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” për arsimin.

Në pikën e tretë të rendit të ditës kemi shqyrtimin dhe votimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, verifikojmë kuorumin. Atëherë, në këtë mbledhje kemi të pranishëm zonjën Eralda Bano, zonjën Merita Bakiu, zotin Eduard Ndreca, zonjën Lindita Buxheli, zonjën Teuta Ramaj, zotin Ismet Beqiraj, zonja Meri Markiçi, zotin Ilir Topi, zotin Petro Koçi, zotin Ilir Metaj, zonjën Desantila Tahiraj, zotin Kastriot Piroli dhe zonjën Blerina Gjylameti. Kuorumin e kemi, kështu që mund të fillojmë menjëherë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të datës 13 nëntor 2023.

Kolegë, nëse jeni dakord, e miratojmë procesverbalin.

Po, faleminderit!

Atëherë, miratohet procesverbali i datës 13 nëntor 2023.

Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin e Buxhetit të vitit 2024. Në dy javët e kaluara ky komision ka pasur, në fakt, një agjendë shumë intensive me seanca dëgjimore me ministrinë e linjës, me ministren e Arsimit dhe Sportit, me ministren e Kulturës, me ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, po kështu edhe me të gjitha institucionet dhe agjencitë e pavarura. Ndërkohë që e kemi miratuar buxhetin në parim, sot do ta miratojmë nen për nen, por ndërkohë kemi edhe një seancë dëgjimore me dy grupe interesi, që po zhvillohet nga fundi, por jo më pak e rëndësishme, me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë.

Të ftuar nga këto sindikata kemi zotin Isa Rekej, kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe zotin Nevrus Kaptelli, president i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë.

Ndërkohë, në mbledhje kemi të pranishëm dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, konkretisht, zotin Gentian Opre nga drejtoria e Analizës dhe Programimit

Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit kemi zonjën Nina Guga, zëvendësministre, zonjën Zamira Gjini, drejtore e Përgjithshëm, zonjën Mirela Bimo, drejtore e Financave dhe Buxhetit, si dhe zonjë Ermelinda Durmishi, drejtore e Politikave të Arsimit të Lartë.

Faleminderit të gjithëve!

Mirë se keni ardhur!

Fillojmë menjëherë me dy përfaqësuesit e sindikatave. I pari fillon zoti Isa Rekaj dhe, më pas, zoti Nevruz Kaptelli, për të bërë një prezantim të shkurtër dhe, më pas, kolegët e komisionit, deputetët, mund të bëjnë pyetje, komente apo edhe diskutime.

Zoti Rekaj, fjala për ju.

Nuk ju dëgjojmë.

Ju lutem, ndizni mikrofonin!

Ende nuk ju dëgjojmë. E keni të mbyllur mikrofonin.

Atëherë, vijojmë me zotin Nevruz Kaptelli, sa të përgatitet zoti Rekaj me mikrofonin.

Zoti Kaptelli, më dëgjoni?

Nevrus Kaptelli – Po, ju dëgjoj.

Evis Kushi - Ju lutem, a mund të filloni, derisa të përgatitet zoti Rekaj?

Nevrus Kaptelli - Po, patjetër.

Evis Kushi - Vazhdoni.

Nevrus Kaptelli – Faleminderit që na dhatë mundësinë që të dëgjohej mendimi i sindikatave në Komisionin parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik!

Unë dua ta filloj si çdo vit tjetër fjalën time, sepse do të dëshiroja që në përputhje me nenin 29 të ligjit nr. 69/2012, fillimisht buxheti të ishte diskutuar në ministri, në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar. Kjo gjë do të na jepte mundësinë që edhe nëse nuk do të ishim në këtë komision, do t'i kishim dhënë mendimet tona në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Megjithatë, edhe unë, edhe kolegu e dimë dhe kemi biseduar, edhe pse ne kemi qenë çdo vit në këtë komision për të diskutuar për projektbuxhetin e viteve pasardhëse për arsimin, që asgjë nuk do të ndryshojë, por megjithatë ne duam të themi disa nga mendimet tona se si mendojmë ne si sindikatë për pasur një buxhet të mjaftueshëm, për një arsim cilësor. Ne e kemi thënë prej kohësh, çdo vit pothuajse ne kemi përsëritur të njëjtën gjë: nëse arsimi do të vlerësohet si prioritet nga qeveria, atëherë, kërkesa e parë është që buxheti për arsimin të rritet dhe të shkojë deri në 5% të GDP-së. Vetëm kështu mund të plotësohen nevojat për kushte më të mira pune për mësuesit, për paga më të larta dhe për një infrastrukturë bashkëkohore në të

gjitha institucionet arsimore. Megjithatë, duke parë përsëri që buxheti për vitin 2024 do të jetë 52,87 miliardë lekë, ne mendojmë se ky buxhet nuk i përmbush kërkesat e kohës për një arsim cilësor, duke pasur parasysh që me arsimin janë të lidhura të gjitha degët e tjera të ekonomisë. Nëse do të kemi një arsim të zhvilluar, një arsim të përparuar, atëherë do të kemi edhe një ekonomi më të zhvilluar. Ne mendojmë që ky buxhet nuk i përmbush nevojat për një arsim cilësor. Në buxhet thuhet që rrogat do të rriten 23% deri në 36% të pagës bruto. Rritja e këtyre pagave, e kemi biseduar edhe bashkë me ju, zonja Kushi, kur ishit ministre, ne mendojmë se është e pamjaftueshme, sepse kjo rritje page nuk ndikon te maturantët dhe te studentët, që studentët më të mirë t'u drejtohen degëve dhe fakulteteve të mësuesisë. Ne shohim që nga viti në vit një nga arsyt kryesore pse studentët po i braktisin fakultetet e mësuesisë është edhe paga e mësuesve. Edhe në Këshillin Kombëtar të Punës e kam ngritur me forcë shqetësimin që paga e mësuesve për ne është kryesorja, pasi e ka bërë profesionin e mësuesit një profesion të padëshiruar për të rinjtë. Për këtë arsye do të donim që paga mesatare e mësuesve të mos jetë 90 000 lekë, por paga minimale e një mësuesi në arsim duhet të jetë 90 000 lekë, aq sa e ka menduar qeveria pagën mesatare. Po ashtu, ne kërkojmë që rritja e pagave të fillonte që nga muaji janar. Meqenëse ky është një projektbuxhet për vitin 2024, ne do të dëshironim që pagat për mësuesit të rriteshin në mënyrë serioze dhe në korrik të vitit 2024 të bëhej dyfishimi i pagës së mësuesit. Ne mendojmë se kjo është e vetmja zgjidhje e problemit të arsimit në Shqipëri në kushtet e sotme.

Le të mendojmë pak për atë që kanë thënë, vetëm para 2 ditësh, rezultatet e Institutit të Studimeve Ndërkombëtare, ku nga sondazhet e tyre në Shqipëri rezulton se mbi 50% e popullsisë kërkon të largohet nga vendi. Unë mendoj, jo se merrem me arsimin, por një nga arsyt kryesore pse njerëzit largohen nga Shqipëria është edhe arsimi. Është arsimi në atë që unë sapo thashë: arsimi duhet që të jetë prioritet kryesor i qeverisë, dhe për të zgjidhur problemet e arsimit dy janë rrugët, njëra është që buxheti i arsimit duhet të shkojë nga 3% në 5% të GDP-së. Le të shkurtohet administrata, sepse për mendimin tonë si sindikata, administrata ka ardhur gjithnjë duke u fryrë, duke u rritur. Edhe pse u shkrinë komunat, përsëri paguhën shumë njerëz, por këto lekë mund t'i kalojnë arsimit. Le të merren lekë nga drejtime të tjera të ekonomisë dhe t'i kalojnë arsimit, sepse ky investim që do të bëhet në arsim, do t'i shërbejë rritjes së ekonomisë dhe rritjes së mirëqenies. Ne mendojmë se kjo është e vetmja mënyrë për të parandaluar emigracionin nga vendi.

Gjithashtu, po të shohim, ky buxhet është i pamjaftueshëm edhe për trajnimin e mësuesve. Ne kërkojmë vetëm që të zbatohet neni 59 i ligji nr. 69/2012 për trajnimin e mësuesve, ku shteti të marrë përsipër, të paktën, deri në 3 ditë trajnim për të gjithë mësuesit që

janë në sistem. Këto trajnime janë bërë shumë të domosdoshme, edhe duke parë situatën e kohëve të fundit në arsim, problemet mësues- nxënës. Këto janë arsyeja e dytë, përveç pagave, që profesioni i mësuesit po bëhet një profesion i padëshiruar nga të rinjtë. Ne i kemi kërkuar edhe ministres së re që trajnimet të kryhen nga fakultetet e mësuesisë. Për ne agjencitë që kanë marrë licenca në ministri për trajnimin e mësueseve janë të dështuara, pasi ato janë kthyer në një biznes. Mua më vjen keq nëse kjo situatë do të vazhdojë ende kështu, megjithëse ministrja e re ka premtuar që do të bëjë ç'është e mundur që trajnimi i mësuesve t'u kalojë fakulteteve të mësuesisë.

Ne jemi në vitin 2024 dhe përsëri mendoj që ky buxhet është i pamjaftueshëm për të pajisur të gjitha shkollat me teknologji bashkëkohore për të realizuar me sukses Smip-in dhe metoda të tjera bashkëkohore të mësimdhënies, në mënyrë që edhe shteti ynë të ecë në të njëjtin hap me shtetet e tjera të rajonit, të paktë, në të kundërt, në shatorit që vjen do të shohim që pjesa më e mirë e maturanëve do të kërkojnë të studiojnë jashtë shtetit, por një pjesë e konsiderueshme e tyre shkojnë në shkolla private.

Nuk është sekret të themi sot që numri i nxënësve në gjimnazet private në Fier po e kalon numrin e nxënësve në gjimnazet publike dhe ky është një realitet. Kjo gjë duhet t'i vërë në lëvizje të gjithë deputetët e nderuar të këtij komisioni, që të ndikojnë fort te qeveria, që të rrisë buxhetin për arsimin, për një arsim bashkëkohor, si dhe për të ndalur largimin e shqiptarëve nga vendi.

Faleminderit!

Evis Kushi – Zoti Kaptelli, shumë faleminderit për sugjerimet tuaja!

Në fakt, ju përmendët rritjen e pagave dhe sugjeruat që rritja e pagave duhet të jetë më e madhe. Në fakt, ne të gjithë biem dakord që mësuesit meritojnë të vlerësohen me dinjitet, me paga të larta, por ama duhet ta theksojmë që rritja e pagave që parashikon ky buxhet për mësuesit është rritja më e madhe e bërë ndonjëherë në gjithë këto vite.

Pra, pavarësisht se ne biem dakord që mësuesit meritojnë edhe më shumë, por duhet ta theksojmë që është rritja më e madhe e bërë ndonjëherë. Shqipëria, me këtë rritje pagash për mësuesit, nuk është më në vendin e fundit, siç ka qenë në rajon, por për kategori të caktuara ndoshta arrin në vendin e parë dhe për disa të tjera në vendin e dytë. Pra, kjo është një rritje e konsiderueshme. Sigurisht që mësuesit do të jenë gjithmonë në vëmendjen e qeverisë, këtë e ka deklaruar edhe Ministrja, edhe Kryeministri. Dua thjesht ta theksoj këtë detaj, sepse jemi të gjithë shumë të lumtur që mësuesit do të kenë paga shumë më të larta me buxhetin e këtij viti.

Ndërkohë që ngritët një shqetësim për sa i takon buxhetit, duke thënë se është një buxhet i ulët. Pa dyshim që të gjithë duam që buxheti të jetë sa më i lartë, por nuk e di nëse

keni zëra specifike ku mendoni që buxheti është i pamjaftueshëm, apo i referoheni në përgjithësi? Sepse përmendët trajnimin e mësueseve dhe jam dakord, por, nuk e di, kishit një sugjerim konkret për një zë të caktuar, apo jo?

Po, zoti Kaptelli.

Hapeni pak mikrofonin, ju lutem!

Nevrus Kaptelli – Edhe përpara 9 vjetësh, kur qeveria premtoi që arsimit do të jetë prioritet, ne përsëri këtë kërkesë kemi pasur. Pra, ne kemi buxhetin më të ulët nga vendet e tjera të zhvilluara për arsimin, 3% të GDP-së, dhe kemi kërkuar që kjo shumë vit pas viti të rritet dhe të shkonte në 5%. Nëse do të kishim pasur një rritje graduale vit pas viti, natyrisht, tani buxheti do të ishte 5% dhe do të plotësonte të gjitha nevojat për një infrastrukturë dhe mjedise mësimore bashkëkohore. Në atë kohë ne kërkonim që të gjitha klasat e gjimnazeve të pajisen me tabela digjitale për një mësimdhënie bashkëkohore. Natyrisht, edhe trajnimi i mësuesve në Shqipëri, ju duhet ta dini më mirë se unë, është shumë mbrapa krahasuar me mësuesit e Maqedonisë dhe të Kosovës. Vetëm me këto dy vende do krahasohemi.

Dhe unë e mirëkuptoj kur ju thoni që është një rritje pagash e madhe. Dakord, për këtë rritje pagash, por unë mendoj se ne pagat i kemi më të ulëta se Maqedonia dhe Kosova, dhe ne nuk e dimë sa ato do t'i rrisin pagat në vitin 2024.

Megjithatë, pa hyrë te krahasimi me pagat e dy vendeve më të afërta të rajonit, unë do të thosha që këto paga për arsimin janë të pamjaftueshme, sado që e kam thënë dhe e kemi biseduar edhe bashkë në një takim të Këshillit Kombëtar për Arsimin Parauniversitar, që Shqipëria edhe për pak vite nuk do të ketë më mësues.

Ne e shohim tani që na mungojnë mësues të ciklit të ulët, ata të lëndëve të matematikës dhe fizikës, ndoshta edhe për pak vite nuk do të ketë as mësues të degëve të tjera. Madje, më keq akoma, duhet të jemi të gjithë në një mendim me këtë, që prej shumë vitesh, jo këta 10 vjet, që në degët e mësuesisë po na shkojnë maturanët me mesataren më të ulët. Kjo do të thotë që fëmijët e të rinjve që janë sot do t'i mësojnë ata nxënës që ne u kemi vënë një 5 në gjimnaz për t'i kaluar. Kjo është alarmante dhe e ardhmja, sipas meje, do të jetë ajo që është në Fier, që të gjithë ata të cilët do të ngelen në Shqipëri, do të mundohen me sakrificat t'i çojnë fëmijët e tyre drejt arsimit jopublik.

Mirëpo ne, si sindikata, po qoftë edhe ato botërore, edhe ato europiane, ku jemi të anëtarësuar, kemi një kërkesë të përbashkët, që ne duhet të punojmë për arsim publik cilësor. Ne tashmë jemi koshientë që, unë kam pyetur vetë në çdo rreth ku shkoj, nuk gjen dot një mësues që fëmijët e tij t'i çojë në degën e mësuesisë. Atëherë, nëse do të mendojmë arsyen, e para është paga.

Unë i kam thënë edhe ish-ministres së Financave në Këshillin Kombëtar të Punës, që ju mund t'i rrisni pagat, mund t'i bëni edhe 1500 euro pas një viti, por ai mësues, njëri që ka ikur në Francë dhe tjetri që ka ikur në Gjermani, nuk do të vijë vitin që vjen as për 1500 euro në Shqipëri. Prandaj, mua më duket një kërkesë e nevojshme dhe shumë urgjente rritja e pagave në arsim, sepse nuk ka, mendoj unë, asnjë rrugë tjetër se si t'i nxisim të rinjtë që këta të shkojnë drejt fakulteteve të mësuesisë.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti Kaptelli!

Unë nuk po hyj në debat tani, sepse do të vijojmë diskutimet me përfaqësuesit e ministrisë, por nuk mund të rri pa e thënë që nuk jam dakord me ju, kur thoni se kemi pagat më të ulëta edhe sesa Maqedonia e Veriut dhe Kosova, pasi me rritjen e re, nuk jemi më në ato nivele. Mund t'u referoheni statistikave, madje ju siguroj për këtë, që me rritjen e re, ne ia kalojmë për kategori të caktuara edhe Kosovës, edhe Maqedonisë së Veriut, ashtu sikurse edhe për trajnimet, nuk mund të themi që jemi në vendin e fundit. Pra, nuk bie dakord me shumë nga deklaratat tuaja.

Megjithatë, së pari, dua t'ju them që na janë bashkuar në mbledhje zonja Nebiaj, zoti Spaho, zonja Zake, kishim edhe zonjën Zhupa me pankartat e saj, por qenka larguar. Na u bashkua në mbledhje.

Atëherë, ia kaloj tani fjalën zotit Isa Rekaç, kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës.

Fjala për ju, zoti Rekaç.

Isa Rekaç – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Faleminderit që na ftuat në këtë takim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik!

Në fakt, e kërkuam sepse nuk kishim të dhëna të plota për buxhetin e vitit 2024, por besoj se nga ky takim do të dalim më të qartë.

Në fakt, buxheti është momenti më i rëndësishëm i vitit, aq më tepër kur flasim për arsimin. Me aq të dhëna sa kemi, ky buxhet ka një rritje më shumë se normalja, pra një rritje nga viti 2023, që nuk është e njëjtë me rritjet në vitet paraardhëse. Pra, ka një rritje më të lartë buxheti që shkon për rritjen e pagave të mësuesve, buxhet që shkon për ndërtimin e shkollave, buxhet që shkon për trajnimin e mësuesve, për mjetet mësimore, për zgjerimin e aftësive (të përfitohen sa më shumë aftësi digjitale), pra për laboratorët e të tjera me radhë.

Natyrisht, ky buxhet shkon edhe për studentët e fakulteteve të mësuesisë që përfitojnë bursë nëse u drejtohen atyre fakulteteve, pra për studentët përmes të cilëve ne duam të rrisim

cilësinë, e të tjera fusha ku ky buxhet është i pranueshëm dhe më i larti që kemi parë, të paktën ne si sindikata që kemi marrë pjesë në këtë debat.

Kur ne flasim për arsim cilësor, ai është i matshëm dhe, siç e dimë të gjithë, për të vlerësuar arsimin cilësor, ne duhet të vlerësojmë tri shtyllat ku ai mbështetet.

E para është mësimdhënia cilësore, që, siç e dimë, realizohet nga mësuesit.

Ne kemi mësues cilësorë, që i kanë kaluar të gjitha fazat e shkollimit në përputhje me ligjin, por pagat i kemi të ulëta, gjë e cila nuk i motivon mësuesit, dhe trajnime që nuk realizohen në përmasat që duhet t'i kemi. Sot u kushtohet shumë rëndësi trajnimeve të mësuesve. Jam dakord me atë që tha kolegu, po edhe me çfarë u shpreh nga dikush tjetër aty, trajnimet duhet të varen nga Ministria e Arsimit, sepse është përgjegjësi dhe detyrim i saj, madje Ministria e Arsimit duhet t'ua delegojë strukturave të saj. Ama, duhet të përgjigjet ajo për këtë dhe trajnimi të jetë falas.

Sot e reja vjetrohët edhe brenda ditës, prandaj trajnimet janë të domosdoshme.

Vendet e Bashkimit Europian, ku ne jemi në kontakt me sindikatat përkatëse, ku edhe ju jeni, besoj, i japin shumë rëndësi trajnimit. Pra, kjo si shtyllë e arsimit cilësor nuk funksionon.

Shtylla e dytë përfshin mjetet mësimore cilësore për mësimdhënie. Ne kemi mjete mësimore, pra nuk mund të themi që nuk kemi laboratorë, por koha kërkon më shumë. Ne tani po plotësojmë regjistrin elektronik ose të dhënat e SMIP-it, ndërkohë që klasat ku zhvillohet mësimi nuk kanë internet dhe mësuesit nuk kanë laptopë. Kësisoj nuk mund të plotësohet regjistri në orën e mësimi dhe, kur nuk plotësohet në orën e mësimi, çdo plotësim para dhe pas orës së mësimi është i papranueshëm. Siç e shikojmë, edhe kjo shtyllë çalon.

Ndërkohë, po të kalojmë te shtylla e tretë, ambiente të përshtatshme për mësimdhënie dhe nxënie, ne kemi shkolla që janë ndërtuar me të gjitha kushtet, që janë të barabarta me vendet e Bashkimit Europian, por kjo nuk mjafton. Ne këto i kemi në zonat urbane, ndërkohë që në zonat rurale kemi shkolla me shumë probleme.

Kështu që, kur flasim për arsim cilësor, ne duhet t'ia ofrojmë atë edhe një nxënësi kudoqoftë, edhe në zonat më të largëta. Arsimi cilësor nuk është ndonjë privilegj, por është detyrim i qeverisë dhe duhet ta realizojmë.

Pra, duke e parë nga ky këndvështrim ose nga analiza e të tria shtyllave në të cilat mbështetet arsimi cilësor, ne kemi shumë punë për të bërë dhe ky buxhet nuk është i mjaftueshëm. Por për ne shtrohet pyetja, sepse ne nuk kemi të dhëna të sakta: sa do të jetë rritja e pagave për mësuesit më 1 korrik të vitit 2024? Sepse aty thuhet nga 23 deri në 36, por ky është disnivel. Ndaj shtrohet pyetja: sa do të jetë realisht paga e mësuesve më 1 gusht të vitit

2024? Dhe a është nisur qeveria nga Strategjia Kombëtare për Arsim, e cila thekson se “rritja e pagave, në krahasim me 1 janarin 2025, do të jetë 40% më e lartë se nga 1 janari i vitit 2021”? Këtë gjë ne, si sindikata, e kemi diskutuar këtë edhe me zonjën Kushi, edhe me paraardhësit, dhe kjo rritje është e pranueshme.

Kërkesa jonë ishte që të kishte rritje çdo vit nga 10%. Megjithatë, ne kemi rënë dakord që, nëse kjo realizohet, pra në qoftë më 1 janar të vitit 2025 pagat e mësuesve do të jenë 40% më të larta nga 1 janari i vitit 2021, ne jemi në rregull, pra jemi dakord, por atëherë do ta bëjmë këtë analizë, pasi shpeshherë na ka ndodhur të thuhet se rriten pagat 15% dhe pastaj, ndërkohë, ato janë rritur 10%. Ose është thënë që rriten pagat 7%, kur ishte thjesht një indeksim i pagave për shkak të inflacionit. Pra, nuk jemi plotësisht të bindur.

Megjithatë, rritja do të jetë e madhe, por ne kërkojmë që të jetë në raportin 40%, sipas Strategjisë Kombëtare të Arsimit, që është një strategji e mirëstudiuar.

Ne e kemi parë me shumë kujdes, por kemi biseduar edhe me zonjën Kushi më parë, madje duhet t’i falënderojmë ata që kanë punuar me aq kujdes për Strategjinë Kombëtare të Arsimit, dhe ajo rritje mbështetet te zhvillimi i vazhdueshëm i ekonomisë, nga rritja e vazhdueshme e ekonomisë dhe nuk është artificiale, prandaj them se duhet të jetë rreth 40%.

Ndërkohë, pyetjet e tjera janë: a do të ketë internet për mësuesit në të gjitha klasat ku zhvillohet mësim? A do të kenë mësuesit laptop ose, më thjesht, *ipad* për plotësimin e regjistrit elektronik?

Pyetja e fundit, që unë e quaj kryesore, e përmendi edhe kolegu im: sa do të jetë buxheti për arsimin në raport me prodhimin e brendshëm bruto? Në qoftë se mbetet në parametrat që ka mbetur në 30 vjet, rreth 3% në raport me prodhimin e brendshëm bruto, ne nuk kemi hapësira të mjaftueshme që të krijojmë apo të kemi një arsim cilësor.

Faleminderit, zonja Kushi!

Faleminderit edhe deputetëve të tjerë!

Evis Kushi – Shumë faleminderit, zoti Reka!

Faleminderit edhe për objektivitetin tuaj se “i pranojmë punët e mira që janë bërë, por, ndërkohë, patjetër që objektivat tona janë shumë më të mëdha, po edhe kërkesat tona për mësuesit, për cilësinë e arsimit, sigurisht, janë edhe më të mëdha”!

Unë besoj që në këtë moment duhet t’ua kalojmë fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, edhe për t’iu përgjigjur disa prej pyetjeve apo shqetësimeve tuaja, qoftë për sa i takon rritjes së pagave, sa do të jetë konkretisht, qoftë për sa i takon internetit apo infrastrukturës shkollore, le të themi, që duhet të bëjë të mundur mësimin apo plotësimin e regjistrit elektronik, apo objektivat e tjera.

Zonja Guga, fjala për ju.

Nina Guga – Më dëgjoni?

Përshëndetje!

Evis Kushi – Ju dëgjojmë.

Përshëndetje!

Nina Guga – Faleminderit, zonja Kushi!

Përshëndetje të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe të ftuarve në këtë mbledhje!

Unë do ta filloja pikërisht me faktin që kemi përpara tashmë një buxhet që është më i larti në këto vite, që i dedikohet arsimit në kuadër të rritjes së pagave të të gjithë punonjësve arsimorë, në kuadër të rritjes së investimeve në infrastrukturë, sigurisht edhe në atë digjitale nëpër shkolla, si dhe në kuadër të financimit të shumë programeve të ndërkombëtarizimit dhe kërkimit shkencor në mbështetje të studentëve.

Pra, buxheti i vitit 2024, që unë do ta quaja shumë, si të thuash, është me pritshmëri të larta, për të realizuar ne sfidat dhe objektivat që i kemi vënë arsimit për strategjinë 2021-2026 dhe, njëkohësisht, për mundësimin e qëllimit final ose qëllimit më të madh që kemi në vizionin tonë për një arsim cilësor.

Kështu që unë do të ndalesha më konkretisht në faktin që në buxhetin e këtij viti ajo çfarë është më e rëndësishmja për t'u theksuar janë pagat e mësuesve, që parashikohen në shumat 4 miliardë lekë dhe 56 miliardë e 223 milionë lekë, ose 9 miliardë e 49 milionë lekë më shumë nga buxheti fillestar i vitit 2023.

Ndoshta me detaje për vlerat buxhetore mund të flasim edhe përfaqësuesit e tjerë të Ministrisë së Arsimit dhe ata të Financave, por më duhej ta theksoja, pasi është një shifër kaq më e lartë në krahasim me vitin e kaluar.

Njëkohësisht, në qoftë se ne do të ndalemi në programet buxhetore për vitin 2024, unë do të përmendja programin e planifikimit dhe menaxhimit në administrim me vlerën 1 miliard e 283 milionë lekë ose 2% e buxhetit total të MAS-it; programin e arsimit bazë në vlerën 27 miliardë e 10 milionë lekë ose 52% e buxhetit total të MAS-it për vitin 2024; programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm në masën 17% e buxhetit total të MAS-it; programin e arsimit të lartë në vlerën 13 miliardë e 30 milionë lekë ose 25% e buxhetit total të MAS-it; programin për kërkimin shkencor në masën 3% të buxhetit total të MAS-it, si dhe programin e zhvillimit të sportit dhe rinisë në masën 1%.

Sigurisht, ajo që na bie në sy, në kuadrin e të gjithë buxhetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, është fakti se për sistemin parauniversitar kemi 68,4% të buxhetit total të MAS-it, që janë të ndara në zëra të ndryshëm, si: shpenzime personeli, ku, edhe një herë, vlen të themi

se për 31 punonjësit arsimorë në administratën tonë do të kemi një rritje prej 2,1 miliardë lekësh ose 7,5% më shumë se buxheti fillestar i vitit të kaluar. Pra, duke u përfshirë në politikën e rritjes së pagave për vitin 2024 buxheti për shpenzimet e personelit do të jetë në vlerën 35 miliardë lekë dhe, sigurisht, është i ndarë sipas zërave për sistemin bazë, për mësuesit, për nxënësit që ndjekin arsimin publik, ku futen edhe të gjithë zërat e tjerë që kanë të bëjnë me 1700 mësues ndihmës apo me punonjësit e rinj që futen në sistemin arsimor, duke përfshirë këtu 850 punonjës psikosocialë, 220 punonjës oficerë sigurie, 2300 punonjës mësues që bëjnë praktikantë mësues, pra studentët, sigurisht duke futur këtu edhe të gjithë mësuesit e tjerë që realizojnë mësimin e gjuhës së huaj angleze dhe të TIK-ut në klasën e parë, si dy programe të reja që i kemi futur tashmë.

Njëkohësisht, unë do të ndalesha edhe tek ato që quhen shpenzime korrente, të cilat me zëra do t'i prekja nga pak, që kanë të bëjnë me shpenzimet për transportin e 35 mijë deri në 38 mijë nxënësve dhe 12 mijë punonjësve, mësuesve.

Do të përmendja një rritje në buxhetin për blerjen e teksteve shkollore për rreth 31 mijë nxënës nga klasa e parë në klasën e tretë dhe nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë, që janë falas dhe, sigurisht, për të gjitha kategoritë e tjera në arsimin e mesëm, të lartë, që futen në këtë pjesë të mbulimit të këtij buxheti për tekstet falas.

Ka fonde për të mbuluar shpenzimet me bursa, fonde që mbështesin programe të veçanta në sistemin parauniversitar, programi “art dhe zeje”, programe për rishikimin e kurrikulës në arsimin parauniversitar, programet e digjitalizimit në kuadër të pajisjes së shkollave me *smartlab*-e, ku për këtë vit ne kemi parashikuar edhe 200 shkolla të tjera, ku do të instalohen 216 *smartlab*-e, njëkohësisht shpenzime për veprimtarinë e Maturës Shtetërore, shpenzime për blerje materiale didaktike. Njëkohësisht, dua të theksoj që nga të gjithë këta zëra ne do të insistojmë fort në trajnimet e mësuesve. Për dijeni edhe të dy përfaqësuesve të dy sindikatave, ne si Ministri e Arsimit ...

Kam përshtypjen se zoti Rekaç dhe zoti Halilaj, të cilët kanë qenë në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, u njohën edhe me këto zëra të buxhetit, që unë po i përmend, por njëkohësisht u njohën edhe me disa programe të tjera të reja që Ministria e Arsimit po ndërmerr, një ndër të cilat është platforma kombëtare e trajnime, që ende jemi duke e përpunuar dhe nuk e kemi përfunduar për ta lançuar, ku do të përfshihet një numër shumë i madh mësuesish, kryesisht në fushën e STEM-it, të shkencave, por njëkohësisht edhe në kuadër të digjitalizimit, ku do të kemi trajnim të një numri shumë të madh mësuesish, të cilët do ta përçojnë këtë edhe te mësuesit e tjerë në çdo njësi bazë, që janë shkollat tona, për sa i përket mënyrës dhe qasjes si do të kemi ne parapërgatitjen tonë për provimet ndërkombëtare PISA,

PIRLS-i, TIMSS-i, që sigurisht do t'i përjasim me të gjitha kërkesat e këtyre lloj provimeve ndërkombëtare, që duhet t'i realizojmë edhe në vendin tonë me të njëjtat standarde.

Njëri nga përfaqësuesit, zoti Kaptelli, pyeti se ku do të bëhen këto trajnime. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar u tha që këto trajnime do të mbulohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, por edhe nga institucione të tjera, që mund të jenë edhe institucionet e arsimit të lartë, gjithmonë në kuadër të bashkëpunimit me ne për këto trajnime.

Gjithashtu, për sistemin parauniversitar dua të përmend investimet për rikonstruksione, për pajisje mobilierie në shkollat e rehabilituara, por edhe në ato që do të ndërtohen rishtas, për blerje pajisjesh kompjuterike, elektronike (kompjuter, laptop). Gjithashtu, është parashikuar financim rreth 230 milionë lekë në vit për 180-200 objekte shkollore për të pajisur klasat me laboratorë mësimorë.

Tashmë me buxhetin e Ministrisë së Arsimit ne jemi të përfshirë në një program për sa i përket digjitalizimit, por edhe me donatorë dhe kredi të ndryshme që Ministria e Arsimit ka marrë. Për sa i përket digjitalizimit dhe pajisjes së shkollave me kompjutera, tendenca jonë është që në çdo klasë të kemi nga një laptop, në mënyrë që mësuesja ta ketë më të lehtë punën për sa i përket përdorimit të regjistrit elektronik në klasë, por njëkohësisht jemi duke e shtuar këtë numër edhe me buxhetin që parashikon MAS-i, por edhe me donatorë të tjerë. Pra, tendenca është në drejtim të shtimit të kapacitetit të internetit nëpër shkolla. Fakti që ne nuk kemi më regjistër *hard copy*, por kemi regjistër elektronik, tregon që ne jemi duke marrë masat e duhura që SMIP-i (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar) të funksionojë më së miri dhe të lehtësohet një pjesë e punës së mësuesve.

Dua të përmend, gjithashtu, edhe laboratorët që do të financohen në shkenca si fizika, kimia dhe biologjia. Këtë vit do të financohen 160 milionë lekë për pajisjen e 80 klasave me laborator. Po ashtu, dua të përmend rishikimin e fondit të bibliotekave, që do të ketë një shtesë në buxhetin e këtij viti.

Siç e përmenda, përveç investimeve që Ministria e Arsimit merr përsipër në bashkëpunim edhe me bashkinë, sidomos me bashkinë e Tiranës, me të cilën kemi planifikuar ndërtimin e 9 shkollave për sistemin arsimor parauniversitar, dua të përmend edhe 185 objekte arsimore të përfshira në programin e rindërtimit nga donatorë, si *EU4 Schools* dhe *UNDP*.

Pra, besoj se me të gjitha sa thashë ju krijova një panoramë për buxhetin e Ministrisë së Arsimit për sistemin parauniversitar.

Ka ende për të thënë, ashtu sikurse edhe u theksua. Një buxhet edhe më i shtuar për paga më të arta për mësuesit patjetër që do të çojë në rritjen e cilësisë në të gjitha fushat e

sistemit parauniversitar. Pra, unë mendoj se buxheti i këtij viti na bën pak më optimistë për realizimin e objektivave tona.

Faleminderit!

Evis Kushi – Zonja Guga, shumë faleminderit për të gjitha sqarimet tuaja! Ndoshta vlen të sjellim në vëmendjen e përfaqësuesve të sindikatave që ne këtu diskutojmë buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ndërkohë që kur flasim për buxhetin për arsimin, ky është më i gjerë sesa vetëm buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Sigurisht, buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka peshën më të madhe, por nuk duhet të harrojmë që janë edhe bashkitë, janë organet e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë në buxhetet e tyre zëra për sa i takon përmbushjes së të gjitha kompetencave që ligji jep, siç është infrastruktura apo edhe detyra të tjera. Po kështu, edhe nga universitetet.

Pra, diskutuam faktin sa për qind e GDP-së është buxheti, por duhet të kemi në vëmendje që buxheti për arsimin është më i lartë sesa buxheti që ne diskutojmë këtu dhe që administron Ministria e Arsimit dhe Sportit.

E falënderoj zonjën Guga që na solli zërat e buxhetit, sepse ky është vërtet buxheti më i madh ndonjëherë për arsimin dhe sportin!

Ka ndonjë pyetje apo çështje për t'u diskutuar nga kolegët deputetë?

Zonja Zake, fjala për ju.

Enslmvera Zake - Faleminderit, zëvendëskryetare!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të sindikatave, të cilët ne i kemi mirëpritur çdo vit! Ju keni qenë edhe vetë prezente si ministre e Arsimit dhe Sportit në të gjitha takimet që kemi pasur me ta.

Takimi i sotëm është i fokusuar kryesisht tek interesi që kanë sindikatat për pagat, kushtet e punës, infrastrukturën, por edhe transportin. Duke parë të gjitha këto elemente, pavarësisht se buxhetin ne e kemi votuar në tërësi dhe e kemi diskutuar në shumë seanca dëgjimore, por edhe në relatimet që ka bërë ministrja përkatëse për buxhetin e arsimit, si dhe faktin që, ashtu siç e thatë ju, buxheti i arsimit nuk i referohet vetëm vlerës mbi 3% të produktit të brendshëm bruto, por edhe tri elementeve të tjera, si pushteti vendor, që ju e cituat, universitetet, dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që është ministria përgjegjëse për arsimin profesional, e cila brenda fondit të saj akordon fonde për arsimin profesional, buxheti për arsimin në tërësi është shumë më tepër sesa kaq.

Ne mund të themi se buxheti i Ministrisë së Arsimit për këtë vit është 5,5 miliardë lekë më shumë sesa buxheti i parashikuar i vitit 2023 ose, e thënë në shifra më të thjeshta, gati 10% më tepër se buxheti i vitit 2023. Kjo është një shifër domethënëse. Ky buxhet fokusohet në

politikën e rritjes së pagave të mësuesve nga 23% deri në 36%, duke filluar nga data 1 korrik e vitit 2024. Për t'i kthyer përgjigje edhe dy përfaqësuesve të sindikatave, zotit Kaptelli dhe zotërisë tjetër, ndjesë për emrin, rritja e pagave varion nga masa 23% deri në 36%, sepse do të varet nga profili i punës ku mësuesit janë fokusuar në arsimin parauniversitar, arsimin fillor apo arsimin e mesëm, por edhe nga vjetërsia që ata kanë në punë. Kjo është një shifër progresive, sepse në klasifikimin dhe kategorizimin e pagave të tyre do të merren parasysh të gjitha këto elemente, që në mënyrë eksponenciale rrisin përqindjen e pagës së çdo mësuesi. Pra, nuk është e ndarë sa do të rritet paga për çdo mësues, sepse çdo mësues ka specifikat e veta për sa i përket arsimimit, kualifikimit apo vjetërsisë në punë.

Për sa u përket kushteve të punës, këtë vit Ministria e Arsimit ka akorduar fond për ndërtimin apo rindërtimin nga fillimi të 30 shkollave në të gjithë Republikën e Shqipërisë, përveç fondeve që pushteti vendor do të akordojë për rindërtimin e shkollave apo kopshteve; për transportin e mësuesve dhe nxënësve, siç e tha edhe zonja Guga, që të mos biem në përsëritje, por edhe për infrastrukturën në universitete. Për herë të parë Ministria e Arsimit akordon fonde për rikonstrukcionin e të gjitha universiteteve.

Po citoj disa objekte universitare që do të rindërtohen: godina e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Kampusi i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Gjeologji-Minierave, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Teknike në Universitetin e Elbasanit, Fakulteti i Studimeve Profesionale në Universitetin e Durrësit. Gjithashtu, janë edhe rreth 80-100 projekte me donatorë të huaj në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor.

Po këtë vit Ministria e Arsimit do të akordojë një fond për kërkimin shkencor 40% më të lartë se vitet e tjera.

Gjithashtu, në kuadër të Paktit për Universitetin dhe Strategjisë Kombëtare të Arsimit, për të cilën ju keni qenë nismëtare, zonja Kushi, ka një mbështetje studentore për mbi 50 mijë studentë me bursa për studentët ekselentë, reduktim të pjesshëm apo të plotë të tarifave të studimit për studentët në cikle të ndryshme të studimit, si dhe bursa për studentët që ndjekin degët prioritare, që akordohet këtë vit. Buxheti për arsimin gjithmonë është i pamjaftueshëm, por besoj se orientimi i buxhetit të vitit 2024 ka bërë hapa shumë cilësorë.

Kështu që, besoj se edhe përfaqësuesit e sindikatave do t'i marrin parasysh ose do t'i vlerësojnë, sepse zëri i tyre është dëgjuar. Patjetër, edhe ne biem dakord që buxheti për arsimin do të jetë gjithmonë i pamjaftueshëm, pavarësisht sa fonde do të akordohen nga qeveria për këto buxhete.

Faleminderit!

Evis Kushi - Zonja Zake, shumë faleminderit për të gjitha detajet që shtuat!

Ju përmendët Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për buxhetin që i jep arsimit profesional, por ndërkohë unë do të shtoja edhe Ministrinë e Kulturës për Universitetin e Arteve, Ministrinë e Bujqësisë për Universitetin Bujqësor të Tiranës, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për Universitetin Politeknik. Pra, ne po diskutojmë buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit këtu, por po ta llogarisim si përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto, kjo mbështetje është shumë më e madhe, sepse përfshin edhe buxhetet e institucioneve të tjera për arsimin.

Ka kolegë të tjerë që duan të shtojnë diçka tjetër, apo ndoshta edhe nga përfaqësuesit e ministrisë? Nuk ka.

Atëherë, falënderoj përfaqësuesit e sindikatave, zotin Rekej dhe zotin Kaptelli! Padyshim që të gjitha shqetësimet tuaja, jo vetëm ne, por veçanërisht Ministria e Arsimit dhe e Sportit i ka mbajtur shënim dhe jam e bindur që do t'i ketë në konsideratë në punën e saj.

Faleminderit për mendimet dhe sugjerimet tuaja!

Suksese!

Faleminderit përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por edhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë!

Suksese dhe punë të mbarë!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2023, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Evis Kushi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Ilir Metaj, Florenc Spaho, Blerina Gjylameti, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Baku, Kastriot Piroli, Orjela Nebijaj dhe Ismet Beqiraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Flutura Açka, Agron Gjekmarkaj dhe Andia Ulliri.

Të ftuar:

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë,

Nina Guga – zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit,

Zamira Gjini - drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,

Mirela Bimo - drejtore e Financave dhe Buxhetit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit,

Ermelinda Durmishi - drejtore e Politikave të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Evis Kushi - Ndërkohë, bashkë me kolegët e komisionit bëhemi gati për të vazhduar me pikën e fundit të rendit të ditës: votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Bëjmë dy minuta pushim, sa të verifikojmë kuorumin dhe pastaj do të vazhdojmë me votimin.

(Pas pushimit)

Të nderuar kolegë, kuorumin e nevojshëm e kemi, kështu që vazhdojmë menjëherë me procesin e votimit.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri në nenin 22 ndiqet e njëjta procedurë e miratimit të neneve.)

Miratojmë në tërësi projektligjin.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Shumë faleminderit, të nderuar kolegë!

E kemi miratuar buxhetin nen për nen dhe në tërësi.

Shumë faleminderit të gjithëve!

Suksese dhe punë të mbarë!

Faleminderit për prezencën edhe përfaqësuesve të ministrive!

MBYLLET MBLEDHJA